



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:197842

Datë: 08.09.2020

Numri i dokumentit: 01099308

P.nr. 1015/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurve I. M. nga fsh. K- Pejë, për shkak të veprës penale shkrretërimi i pyjeve nga neni 348 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Pejë, PP/II.nr.1922/2019 të dt. 31.10.2019, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar të datës, 31.08.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Muharrem Bajraktari dhe të pandehurit I. M. në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 08.09.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

I. M., i biri i B. dhe nënës H., e gjinisë Z., i lindur me dt. ..., në fsh., me vendbanim Pejë, Rr. identifikohet në bazë të Inj.nr. personal, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion-tregtar, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i pesë fëmijëve, me nr. tel., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

- Me date 20.06.2019, rreth orës 11:00 minuta tek vendi i parkut kombëtar “....” i kategorizuar si Park i mbrojtur, në kundërshtim me urdhrin e organit kompetent bene prerjen e pyllit duke shkatërruar pyllin e mbrojtur në atë mënyrë që: - ditën kritike të pandehurit në parcelat në pronësi private me numër 169/25 dhe 169/26 në fsh., të cilat parcela ndodhen brenda territorit kombëtar “...”, në kundërshtim me ligjin me sharrë motorike kanë prerë drunjtë e llojit “Bre” në vëllim prej 35.11 m³, çka leje për prerje, pa damkë pyjore dhe pa fletë përcjellje të lëshuar nga organi kompetent,

- Me çka ka kryer veprën penale shkretërimi i pyjeve nga neni 348 par. 2 të KPRK-së .

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 39, 40, 43, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 348 par. 2 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPP-së të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit të lartcekur i përcaktohet

- I. Dënimi me gjobë në shumë prej 500 (dyqind) euro, të cilin dënim obligohet që ta paguajë më se largu në afat prej 30 dite, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe
- II. Dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohen në rast se e pandehura brenda periudhës një (1) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që ne emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që ne emër të programin e kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngrit aktakuzë Pejë, PP/II.nr.1922/2019, të dt. 31.10.2019, kundër të pandehurve I. M. dhe N. M. që të dy nga fsh. K-Pejë, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, shkretërimi i pyjeve nga neni 348 par. 2 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 31.08.2020, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe prezentë kanë qene prokurori i shtetit Muharrem Bajraktari dhe të pandehurit I. M. dhe N. M..

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1, të KPP-së, i ka udhëzuar të pandehurit me të drejtat e tyre, ku në këtë rast të pandehurit kanë deklaruar se i kanë kuptuar këto të drejta, dhe se nuk kanë nevojë për mbrojtës.

Para se të lexohet aktakuza prokurori i shteti është tërhequr pjesërisht nga aktakuza PP/II.nr.1922/2019, të dt. 31.10.2019 përkatësisht u tërhoq nga ndjekja penale ndaj të pandehurit N. M. për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje Shkretërimi i pyjeve nga

neni 348 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, prandaj gjykata në kuptim të nenit 292 lidhur me nenin 358 par.2 nënpar 1.3 të KPP-së, ka marrë aktvendim dhe ka pushuar procedurën ndaj të pandehurit N.M., ndërsa ka vazhduar procedurën vetëm ndaj të pandehurit I. M. sipas veprës se rikualifikuar nga prokurori i shteti.

Shqyrtimi fillestar ka vazhduar vetëm ndaj të pandehurit I. M. për shkak të veprës penale shkretërimi i pyjeve nga neni 348 par 2 të KPRK-së

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri I.M. e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e kanë bërë vullnetarisht, pa presion nga askush ndihet i penduar dhe premtion gjykatës se më nuk do të përsërisë vepra te tilla penale.

Prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës, dhe ka propozuar që si rrethanë lehtësues të merret pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: fletëparaqitja e rojtarit te parkut kombëtar me nr. 73 e datës 10.07.2019, raporti për fletëparaqitje, kopja e certifikatës kadastrale për njësinë P-... e datës 14.10.2018, kopja e planit me numër te lendes ...-18, kopja e planit me numër ..., fotografitë nga vendi i ngjarjes si dhe rregullorja MMPH – nr. 01/2015 për shërbimet e Agjensionit për mbrojtjen e mjedisit te Kosovës dhe institucioneve te saja, deklarata e te pandehurit e dhënë ne Prokurorin Themelore e Pejë me dt. 19.02.2020, foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit I. M. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale shkretërimi i pyjeve nga neni 348 par. 2 te KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese

për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, premtimin se nuk do të kryej vepra tjera penale në të ardhmen, faktin se i pandehuri nuk ka qene i dënuar me pare dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 d të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.1015/19 dt. 08.09.2020**

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

GJYQTARI
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.